



Data: 12.07.2017

Ref.: 617/17

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 51-të, të mbajtur më 23 Qershor 2017, mori:

V E N D I M

- I. REFUZOHET kërkesa nr. 235/17, date 04.05.2017 e BPrAL Kolegji “AAB” për akreditim të tri programeve të studimit: Juridik, (PhD 180 ECTS), Ekonomik (PhD 180 ECTS), dhe Gjuhë Angleze (PhD 180 ECTS).
- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

BPrAL Kolegji “AAB” ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për akreditim të programeve të studimit: Juridik, (PhD 180 ECTS), Ekonomik (PhD 180 ECTS), dhe Gjuhë Angleze (PhD 180 ECTS).

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur me 07 prill 2017 ka vlerësuar aplikacionin e BPrAL Kolegji “AAB”, dhe pas shqyrtimit të dosjeve të stafit akademik duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (nr.20/2016, datë 20.09.2016), neni 11, pika 3.2, ku sipas kësaj pike, institucioni duhet të ketë të paktën tre PhD (Dr.sc.) në marrëdhënie të rregullt pune për secilin program studimi, dhe në pajtim me nenin 13, pika 1.1 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim nr.20/2016, datë 20.09.2016, KSHC ka konstatuar që ky aplikacion nuk i përmbush kushtet për aprovim sa i përket stafit akademik, dhe më këtë rast ka refuzuar aprovimin e aplikacionit të BPrAL Kolegji “AAB” për programet e cekura në dispozitiv.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga data e pranimit të këtij vendimi siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit "AAB";
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

